



**COVID-19  
VACCINE**  
Public Health  
Advice

# Vaksinat E COVID-19

**Informacione rreth vaksinë suaj**  
**Pfizer, VidPrevtyl Beta**  
**ose Novavax**

Versioni 8  
12 shtator 2023



**Rialtas na hÉireann**  
**Government of Ireland**

## Rreth kësaj broshure

Kjo broshurë ofron informacione të përgjithshme për vaksinën tuaj për COVID-19. Ka disa broshura të veçanta informuese rreth vaksinës Pfizer për fëmijët e moshës 5-11 dhe 12-15 vjeç në faqen e internetit **[www.hse.ie](http://www.hse.ie)**

Ato janë në dispozicion në internet për t'i lexuar përpara se të merrni vaksinën dhe kjo broshurë do t'ju jepet kur të shkoni për të bërë vaksinën tuaj.

Kjo përmban informacione të tilla si:

- Vaksinat, dozat përforcuese dhe dozat shtesë
- Vaksinat e përshtatura
- Miratimi i vaksinës, siguria dhe monitorimi
- Shtatzënia dhe ushqyerja me gji
- Vaksinat e rekomanduara sipas moshës
- Çfarë të prisni pasi të kenë bërë vaksinën e COVID-19
- Secila nga 3 vaksinat – efektet anësore dhe kur nuk duhet marrë një vaksinë e veçantë

### **Vaksina e COVID-19 e Pfizer – e quajtur edhe Comirnaty**

- » Efektet anësore të mundshme të vaksinës Pfizer
- » Kur nuk duhet ta merrni vaksinën Pfizer

### **Vaksina e COVID-19 VidPrevtyn Beta**

- » Efektet anësore të mundshme të vaksinës VidPrevtyn Beta
- » Kur nuk duhet ta merrni vaksinën VidPrevtyn Beta

### **Vaksina e COVID-19 Novavax - e quajtur edhe Nuvaxovid**

- » Efektet anësore të mundshme të vaksinës Novavax
- » Kur nuk duhet ta merrni vaksinën Novavax
- Koha e nevojshme për funksionimin e vaksinave
- Raportimi i efekteve anësore
- Ku mund të gjeni më shumë informacion
- Informacioni juaj personal

Vaksinuesi juaj mund t'i përgjigjet çdo pyetjeje që mund të keni pasi të keni lexuar këtë broshurë.

Ju lutemi ta ruani këtë broshurë, pasi mund t'ju duhet t'i referoheni përsëri.

Nëse e dëshironi këtë broshurë në një format tjetër si për shembull anglisht Easy Read, anglisht në alfabet Braille, në gjuhën irlandeze të shenjave apo nëse dëshironi një version të përkthyer, vizitoni faqen e internetit

[www.hse.ie/covid19vaccinematerials](http://www.hse.ie/covid19vaccinematerials)

## Rreth vaksinës suaj të COVID-19

Vaksinat e COVID-19 janë mënyra më e mirë për t'u mbrojtur nga COVID-19. Që nga prezantimi i vaksinave, ne kemi parë më pak njerëz që sëmuren rëndë dhe më pak vdekje nga virusi në Irlandë.

Bërja e një vaccine për COVID-19 duhet të zvogëlojë rrezikun e infektimit me COVID-19 dhe t'ju mbrojë nga komplikacionet e rënda. HSE po vaksinon njerëzit në Irlandë për t'i mbrojtur ata dhe për të vazhduar pakësimin e numrit të personave që sëmuren rëndë, si dhe numrin e vdekjeve.

Kjo broshurë përmban informacione rreth 3 vaksinave kryesore në programin e vaksinimit kundër COVID-19 në Irlandë për personat e moshës 16 vjeç e lart:

**Pfizer**, **VidPrevtyn Beta** dhe **Novavax**.

Në Irlandë, vaksinat e COVID-19 të AstraZeneca, e quajtur edhe Vaxzevria, të Janssen (e quajtur edhe Jcovden®) dhe të Spikevax (e quajtur edhe Moderna), nuk përdoren më, por informacione për to mund të gjeni në faqen e internetit [www.hse.ie](http://www.hse.ie)

## Vaksinat, dozat përforcuese dhe dozat shtesë

Kur i referohemi vaksinave në këtë broshurë, ne nënkuptojmë:

- ciklin parësor (doza e parë ose e dytë)
- dozën shtesë – që u ofrohet personave me sistem imunitar të dobët dhe/ose
- një dozë përforcuese

### Cikli parësor

Cikli parësor rekomandohet për të gjithë personat e moshës 12 vjeç e lart.

Cikli parësor përbëhet nga:

- doza e parë dhe doza e dytë, me 4 javë diferencë për personat e moshës 30 vjeç e lart dhe për ata të moshës 12-29 vjeç me një sistem imunitar të dobët
- doza e parë dhe doza e dytë, me 8 javë diferencë për personat e moshës 12-29 vjeç. Për fëmijët e moshës 12-15 vjeç ekziston një broshurë e veçantë informuese

## Doza shtesë

Doza shtesë u ofrohet personave me sistem imunitar të dobët.

## Dozat përforcuese

Mbrojtja që keni marrë nga vaksinat tuaja të mëparshme ose mbrojtja që keni marrë nga infektimi me COVID-19 mund të dobësohet me kalimin e kohës. Doza përforcuese rrisin mbrojtjen tuaj ndaj COVID-19.

Ju mund të konsideroni marrjen e dozës tuaj përforcuese për të mbrojtur edhe të tjerët – për shembull, nëse jeni kujdestar ose jetoni me dikë në rrezik të lartë për COVID-19, si p.sh. dikush me një sistem imunitar të dobët.

Të paktën një dozë përforcuese rekomandohet për të gjithë të rriturit e moshës 18 vjeç e lart. Pas kësaj, për disa njerëz rekomandohen doza përforcuese në vjeshtë.

Një dozë përforcuese në vjeshtë do të ofrohet nëse jeni:

- 50 vjeç e lart
- 5 vjeç e lart me sistem imunitar të dobët
- 5 deri në 49 vjeç me një gjendje që ju vë në rrezik të lartë për t'u sëmurur rëndë nga COVID-19
- një punonjës/e i kujdesit shëndetësor

Për më shumë informacion se kur duhet të bëni vaksinën tuaj të ardhshme të COVID-19, vizitoni faqen e internetit **www.hse.ie** ose telefononi ekipin tonë në HSELive në numrin **1800 700 700**.

Personat e moshës 18-49 vjeç që janë të përditësuar me vaksinat e tyre (cikli parësor dhe doza përforcuese e parë) mund të marrin një dozë përforcuese në vjeshtë pas konsultimit me një specialist të kujdesit shëndetësor.

Nëse keni për të bërë një vaksinë gripi, mund të merrni çdo vaksinë të COVID-19 në të njëjtën kohë me vaksinën e gripit.

## Vaksinat e përshtatura

Vaksinat e Comirnaty që do t'ju ofrohen janë vakcina të përshtatura. Vaksinat e përshtatura të Comirnaty përmbajnë mRNA për të mbrojtur kundër varianteve të llojeve të COVID-19. Këto pritet të japin mbrojtje më të gjerë kundër varianteve të COVID-19 sesa vakcina origjinale.

Vaksinat e përshtatura rekomandohen nga Komiteti Këshillues Kombëtar i Imunizimit dhe janë miratuar nga Agjencia Evropiane e Barnave.

VidPrevtyn Beta bazohet në variantin beta të COVID-19. Mund të përdoret për të mbrojtur kundër COVID-19 vetëm si dozë përforcuese tek të rriturit e moshës 18 vjeç e lart, të cilët kanë marrë tashmë një vaksinë mRNA për COVID-19 ose një vaksinë për COVID-19 me vektor adenoviral (si për shembull Vaxzevria ose Jcovden).

### E rëndësishme:

Këshillat nga Agjencia Evropiane e Barnave (EMA) dhe Komiteti Këshillues Kombëtar i Imunizimit (NIAC) ndonjëherë mund të jenë të ndryshme. Kur kjo ndodh, ne në Irlandë ndjekim udhëzimet e NIAC.

## Miratimi i vaksinës, siguria dhe monitorimi

HSE i përdor vaksinat vetëm kur ato plotësojnë standardet e kërkuara të sigurisë dhe efektivitetit dhe pasi Agjencia Evropiane e Barnave (EMA) i ka licencuar ato.

Vaksinat e COVID-19 u janë nënshtruar të njëjtave provave klinike dhe kontrolleve të sigurisë si të gjitha vaksinat e tjera të licencuara, por megjithatë vaksinat janë ende mjaft të reja dhe informacionet për efektet anësore afatgjata janë të kufizuara.

Ne kemi më pak informacion për sigurinë e dozës së dytë dhe të dozave përforcuese vijuese të vaksinës së COVID-19. Megjithatë, shumë vende u kanë dhënë popullatës së tyre disa doza të vaksinave kundër COVID-19. Studimet tregojnë se deri më tani nuk ka pasur ndonjë shqetësim të papritur sigurie për personat që kanë marrë disa doza përforcuese.

Pritet që siguria e vaksinave të përshtatura të jetë e ngjashme me vaksinat e mëparshme. Siguria e vaksinave do të vazhdojë të monitorohet nga EMA. Të gjitha vaksinat e përshtatura me mRNA përmbajnë Trometamol, që do të thotë se nuk mund t'i merrni ato nëse keni pasur anafilaksi (reaktion i rëndë alergjik) nga Trometamol.

Është zgjedhja juaj për të marrë vaksinën. HSE, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) dhe Departamenti i Shëndetësisë rekomandojnë fort që ju ta merrni vaksinën kur ju ofrohet.

Autoriteti Rregullator i Produkteve Shëndetësore (HPRA) dhe Agjencia Evropiane e Barnave (EMA) monitorojnë vaksinat e COVID-19 për sigurinë dhe efektivitetin e tyre. Ne ju tregojmë më shumë për HPRA në faqen 19.

Në Irlandë, Komiteti Këshillues Kombëtar i Imunizimit (NIAC) i jep Departamentit të Shëndetësisë këshilla për politikën e vaksinave dhe HSE zbaton politikën e departamentit.

## Shtatzënia dhe ushqyerja me gji

Ju duhet ta bëni vaksinën e COVID-19 nëse jeni:

- shtatzënë
- duke u përpjekur për një fëmijë ose mund të mbeteni shtatzënë
- duke ushqyer një foshnjë me gji

Shumica e grave shtatzëna që marrin virusin, edhe nëse nuk kanë bërë ndonjë vaksinë për COVID-19, kanë simptoma të lehta deri në mesatare. Ato lindin sipas planifikimit dhe rreziku i transmetimit të COVID-19 tek foshnjat e tyre është i ulët.

Megjithatë, nëse jeni shtatzënë, keni më shumë gjasa të sëmureni rëndë dhe të keni nevojë për trajtim në kujdesin intensiv. Virusit mund të shkaktojë gjithashtu komplikacione për fëmijën tuaj.

Fëmijët nën moshën 1 vjeç janë në rrezik më të lartë të shtrimit në spital dhe që të sëmuren rëndë nga COVID-19. Foshnjat e reja, nënat e të cilëve ishin vaksinuar gjatë shtatzënisë, kishin më pak gjasa të kishin nevojë për kujdes spitalor me COVID-19.

Nuk ka asnjë provë që vaksinat e COVID-19 ndikojnë në fertilitetin tek burrat ose gratë. Nuk keni pse të vononi të mbeteni shtatzënë pas vaksinës suaj të COVID-19.

Nuk ka asnjë problem sigurie që ta merrni vaksinën tuaj të COVID-19 në të njëjtën kohë me vaksinat e tjera që ju ofrohen gjatë shtatzënisë.

Nëse jeni shtatzënë, ka të ngjarë t'ju ofrohet vakcina **Pfizer**. Kjo është një vaksinë e tipit mRNA – një vaksinë që i tregon trupit tuaj sesi të prodhojë antitrupa që ndihmojnë në luftimin e virusit të COVID-19.

Gjithsesi, nëse doktori ju ka këshilluar që nuk mund të bëni një vaksinë mRNA ose ju nuk dëshironi që të bëni një vaksinë të tillë, mund të konsideroni vaksinën **Novavax** pas konsultimit me një specialist të kujdesit shëndetësor (për shembull një doktor, mami ose vaksinues) për rreziqet dhe përfitimet për juve.

Përveç kësaj, meqë të dhënat klinike në dispozicion janë të kufizuara, NIAC nuk rekomandon përdorimin e zakonshëm të **VidPrevtyl Beta** në shtatzëni. Administrimi i **VidPrevtyl Beta** gjatë shtatzënisë duhet shqyrtuar vetëm rast pas rasti, në konsultim me një specialist përkatës, kur përfitimet e mundshme janë më të mëdha se rreziqet e mundshme.

Ne kemi më pak informacion mbi përdorimin e vaksinave **Novavax** dhe **VidPrevtyl Beta** te grat shtatzëna. Më shumë informacion mund të gjeni në faqen e internetit **www.hse.ie**

Vaksinat e përshtatura për COVID-19 mund të jepen si dozë përforcuese gjatë shtatzënisë.

Nëse nuk e keni kryer ciklin parësor, 2 dozat mund të jepen në çdo fazë të shtatzënisë.

### **Nëse jeni shtatzënë dhe nuk keni bërë kurrë një dozë përforcuese për COVID-19:**

- Vaksina juaj e parë përforcuese rekomandohet të paktën 4 muaj nga doza juaj e fundit e vaksinës së COVID-19 ose nga infektimi i fundit i konfirmuar me COVID-19.
- Ju mund ta merrni dozën tuaj të parë përforcuese në çdo fazë të shtatzënisë.

### **Nëse keni marrë dozën e parë përforcuese përpara se të mbeteshit shtatzënë:**

- Ju duhet të merrni një dozë tjetër përforcuese nëse kanë kaluar më shumë se 6 muaj që kur keni bërë një vaksinë apo jeni infektuar me COVID-19.
- Kjo dozë përforcuese mund të jepet në çdo fazë të shtatzënisë, por rekomandohet ndërmjet javës 20-34. Mund ta merrni më herët nëse kanë kaluar më shumë se 12 muaj nga vaksina ose infektimi i mëparshëm me COVID-19.

Nëse keni ndonjë pyetje, mund të flisni me një specialist të besuar të kujdesit shëndetësor.

Në shtatzëni, juve ju nevojitet vetëm 1 dozë përforcuese për COVID-19. Sidoqoftë, nëse jeni shtatzënë dhe keni një sistem imunitar të dobët, dozën e dytë përforcuese mund ta merrni të paktën 6 muaj pas vaksinës ose infektimit të fundit me COVID-19, në çdo fazë të shtatzënisë.

## Vaksinat e rekomanduara sipas moshës

Të gjitha vaksinat e COVID-19 ju ofrojnë mbrojtje të mirë nga sëmundja e rëndë me COVID-19 kur keni kryer:

- raundin e parë të vaksinave dhe
- çdo dozë shtesë dhe/ose përforcuese të rekomanduar për ju.

Komiteti Këshillues Kombëtar i Imunizimit (NIAC) këshillon që ju mund të merrni çdo vaksinë mRNA për COVID-19 (**Pfizer**) si dozë përforcuese, duke përfshirë vaksinat e përshtatura, edhe nëse më parë keni bërë një vaksinë tjetër.

### Këshillimi sipas grupmoshës:

Në rast se jeni:

- 5 vjeç e lart, do t'ju ofrohet vakcina **Pfizer** për COVID-19.

Nëse nuk mund të bëni një vaksinë mRNA, mund t'ju ofrohet vakcina **Novavax**, ose ndonjëherë vakcina **Vidprevtyn Beta**. **Novavax** është miratuar për përdorim në personat 12 vjeç e lart. **Vidprevtyn Beta** është miratuar për përdorim si një vaksinë përforcuese për personat e moshës 18 vjeç e lart.

Ka këshillim të veçantë rreth vaksinave për fëmijët në faqen e internetit **www.hse.ie**

## Çfarë të prisni pasi të kenë bërë vaksinën e COVID-19

Si të gjitha medikamentet, edhe vaksinat mund të shkaktojnë **efekte anësore**. Shumica e tyre janë të lehta deri mesatare, afatshkurtra dhe nuk shfaqen tek të gjithë.

Efektet serioze anësore, si reaksione të rënda alergjike, janë jashtëzakonisht të rralla. Vaksinuesi juaj është trajnuar të trajtojë reaksione të rralla alergjike serioze.

Efektet anësore mund të jenë të ndryshme për secilën vaksinë dhe ju duhet të lexoni këtë broshurë dhe broshurën e informimit të pacientit nga prodhuesi, për vaksinën që merrni. Broshura e prodhuesit ofrohet në faqen e internetit **www.hse.ie** ose ne mund të printojmë një kopje për ju në ditën kur bëni vaksinën.

Në seksionin në vijim, ne ju tregojmë efektet anësore të njohura të 3 vaksinave kundër COVID-19 të detajuara në këtë broshurë dhe ju tregojmë sesa të zakonshme ose të rralla janë ato. Ne gjithashtu theksojmë se kush nuk duhet të marrë secilën vaksinë. Informacione të tjera mund të gjeni në faqen e internetit **www.hse.ie**



Gjatë gjithë kohës bëhen të disponueshme më shumë informacione. Informacioni në faqen e internetit [www.hse.ie](http://www.hse.ie) përditësohet më shpesh, ndërsa publikohen studime të reja.

### **3 vaksinat – efektet anësore të tyre dhe kur nuk duhet marrë një vaksinë e veçantë**

Në faqet në vijim, ne ju tregojmë për efektet anësore të mundshme dhe kur nuk duhet marrë një vaksinë të veçantë. Ne i kategorizojmë efektet anësore, nga shumë të zakonshme në jashtëzakonisht të rralla.

- Shumë të zakonshme (më shumë se 1 në 10 persona)
- Të zakonshme (deri në 1 në 10 persona)
- Jo të zakonshme (deri në 1 në 100 persona)
- Të rralla (deri në 1 në 1000 persona)
- Shumë të rralla (deri në 1 në 10 000 persona)
- Jashtëzakonisht të rralla. Ende nuk dihet sesa persona që marrin këtë vaksinë do t'i përjetojnë këto efekte anësore, por mendohet se janë jashtëzakonisht të rralla.

Ndërsa vaksinat e ndryshme do të kenë efekte anësore të përbashkëta, ju duhet t'u kushtoni vëmendje efekteve anësore të listuara për vaksinën që merrni. Emri dhe ngjyra e vaksinës janë në kartën e regjistrimit që do t'ju japë vaksinuesi juaj dhe në faqet në këtë broshurë. Ju duhet të shikoni për efektet anësore në orët dhe ditët pas bërjes së vaksinës.

## Vaksina e COVID-19 e Pfizer – e quajtur edhe Comirnaty

Efektet anësore të mundshme dhe shpeshtësia e ndodhisë së tyre jepen të renditura më poshtë, të ndjekura nga këshillat se kur nuk duhet marrë kjo vaksinë. Nëse keni ndonjë dyshim, pyesni gjithmonë një specialist të besuar të kujdesit shëndetësor.

Efektet anësore të mundshme:	
<b>Shumë të zakonshme</b> Më shumë se 1 në 10 persona	<ul style="list-style-type: none"><li>• ndjesi e lodhjes</li><li>• ndjeshmëri ose ënjtje në vendin e injeksionit të vaksinës</li><li>• dhimbje koke</li><li>• dhimbje muskujsh</li><li>• dhimbje kyçesh</li><li>• diarre</li><li>• temperaturë (38 gradë Celsius e lart) ose ethe</li></ul>
<b>Të zakonshme</b> Deri në 1 në 10 persona	<ul style="list-style-type: none"><li>• marrje mendsh</li><li>• të vjella</li><li>• skuqje në vendin ku është bërë vakcina</li><li>• ënjtje e gjëndrave limfatike. Kjo është më e zakonshme pas një doze përforcuese.</li></ul>
<b>Jo të zakonshme</b> Deri në 1 në 100 persona	<ul style="list-style-type: none"><li>• marramendje</li><li>• kruarje në vendin ku është bërë vakcina</li><li>• kruarje të përgjithshme</li><li>• acarim i lëkurës</li><li>• pagjumësi</li><li>• djersitje e shtuar</li><li>• djersitje gjatë natës</li><li>• rënie oreksi</li><li>• mungesë energjie, plogështi ose gjendje jo të mirë</li><li>• dhimbje në krahun ku keni bërë vaksinën</li></ul>
<b>Të rralla</b> Deri në 1 në 1000 persona	<ul style="list-style-type: none"><li>• varje e përkohshme në njërën anë të fytyrës</li><li>• reaksione alergjike si urtikaria ose ënjtje të fytyrës</li></ul>
<b>Shumë të rralla</b> Deri në 1 në 10 000 persona	<ul style="list-style-type: none"><li>• miokardit dhe perikardit. Kjo do të thotë inflamacion i muskullit të zemrës ose i cipës mbështjellëse të muskujve të zemrës. Shihni faqen tjetër për simptomat.</li></ul>

**Jashtëzakonisht të rralla**

Frekuenca nuk dihet ende

- një reaksion alergjik i rëndë
- Eritema Multiforme – një reaksion lëkure që shkakton pika ose njolla të kuqe që mund të duken si një tabelë ose "shënjestër" me një qendër të kuqe të errët, të rrethuar nga unaza të kuqe më të zbehta
- ënjtje e fytyrës nëse keni mbushës (filler) facialë
- ënjtje e konsiderueshme e krahut (ose këmbës) ku është bërë vaksina
- ndjesi dridhjesh ose shpimi, ose humbje e ndjesisë në disa pjesë të trupit
- perioda të rënda

**Simptomat e miokarditit dhe perikarditit**

Miokarditi dhe perikarditi janë gjendje inflamatore të zemrës. Edhe pse rreziku i këtyre gjendjeve është shumë i ulët, duhet të keni parasysh shenjat për të pasur kujdes. Miokarditi dhe perikarditi janë më të zakonshëm te meshkujt nën moshën 30 vjeç, pas dozës së dytë primare të vaksinës. Rreziku i këtyre efekteve anësore duket se është më i ulët pas dozës së parë përforcuese.

Kërkoni ndihmë mjekësore nëse keni një nga këto simptoma pasi të keni bërë këtë vaksinë:

- mosmbushje me frymë
- palpitatione (rrahje të forta të zemrës që mund të jenë të çrregullta)
- dhimbje gjoksi

**Ju NUK DUHET ta merrni vaksinën e COVID-19 të Pfizer (Comirnaty) nëse:**

- Keni pasur një reaksion të rëndë alergjik ndaj cilitdo përbërësi të vaksinës (duke përfshirë polietilen glikolin ose PEG). Lexoni broshurën e informimit të pacientit nga prodhuesi, për të parë listën e përbërësve.
- Keni pasur një reaksion të rëndë alergjik ndaj një doze të mëparshme të vaksinës së COVID-19 të Pfizer ose të Moderna (Spikevax).
- Keni pasur një reaksion të rëndë alergjik nga Trometamoli (një nga përbërësit në lëndën e kontrastit që përdoret në studimet radiologjike MRI).
- Ju është thënë nga një mjek se nuk duhet ta bëni vaksinën e COVID-19 të Moderna (Spikevax) ose vaksinën e COVID-19 të Pfizer për arsye mjekësore.

## **Flisni me mjekun tuaj përpara se të bëni këtë vaksinë të COVID-19, nëse ju:**

- Keni pasur një reaktion të rëndë alergjik (anafilaksi) në të shkuarën, duke përfshirë edhe nga vaksina apo mjekime të tjera
- Keni pasur miokardit dhe perikardit (inflamacion i muskujve të zemrës ose cipës mbështjellëse të zemrës) pas një doze të mëparshme të vaksinave kundër COVID-19

Për fëmijët që kanë pasur më parë sindromën inflamatore multisistemike (MIS-C), ata mund të marrin vaksinën për COVID-19 pasi të jenë shëruar dhe të paktën 90 ditë pasi janë diagnostikuar, cilado që të jetë më e gjatë.

Nëse keni marrë së fundmi vaksinën MPOX (e njohur më parë si lija e majmunëve) (Imvanex ose Jynneos), duhet të prisni 4 javë përpara se të merrni një vaksinë për COVID-19, për shkak të rrezikut të panjohur të miokarditit.

## Vaksina e COVID-19 VidPrevtytyn Beta

Efektet anësore të mundshme dhe shpeshhtësia e ndodhisë së tyre jepen të renditura më poshtë, të ndjekura nga këshillat se kur nuk duhet marrë kjo vaksinë. Nëse keni ndonjë dyshim, pyesni gjithmonë një specialist të besuar të kujdesit shëndetësor.

Efektet anësore të mundshme:	
<b>Shumë të zakonshme</b> Më shumë se 1 në 10 persona	<ul style="list-style-type: none"><li>● dhimbje në vendin ku keni bërë injeksionin</li><li>● dhimbje koke</li><li>● dhimbje muskujsh</li><li>● dhimbje kyçesh</li><li>● ndjesi e përgjithshme e të mos ndierit mirë</li><li>● Ethe</li></ul>
<b>Të zakonshme</b> Deri në 1 në 10 persona	<ul style="list-style-type: none"><li>● skuqje ose ënjtje në vendin ku keni bërë injeksionin</li><li>● temperaturë (38 gradë Celsius e lart)</li><li>● ndjesi e lodhjes</li><li>● marrje mendsh</li><li>● diarre</li></ul>
<b>Jo të zakonshme</b> Deri në 1 në 100 persona	<ul style="list-style-type: none"><li>● kruajtje në vendin ku keni bërë injeksionin</li><li>● nxirje në vendin ku keni bërë injeksionin</li><li>● ngrohtësi në vendin ku keni bërë injeksionin</li><li>● ënjtje e gjëndrave limfatike</li></ul>

### Ju NUK DUHET ta merrni vaksinën e COVID-19 Vidprevtytyn Beta nëse:

- Keni pasur një reaktion të rëndë alergjik ndaj një prej përbërësve të vaksinës (duke përfshirë polysorbate 20 ose octylphenol ethoxylate). Lexoni broshurën e informimit të pacientit nga prodhuesi, për të parë listën e përbërësve.
- Keni pasur një reaktion të rëndë alergjik ndaj një doze të mëparshme të kësaj vaksine.

### Flisni me mjekun tuaj përpara se të bëni këtë vaksinë të COVID-19, nëse ju:

- Keni pasur një reaktion të rëndë alergjik (anafilaksi) në të shkuarën, duke përfshirë edhe nga vaksina apo mjekime të tjera.

## Vaksina e COVID-19 Novavax – e quajtur edhe Nuvaxovid

Efektet anësore të mundshme dhe shpeshtësia e ndodhisë së tyre jepen të renditura më poshtë, të ndjekura nga këshillat se kur nuk duhet marrë kjo vaksinë. Nëse keni ndonjë dyshim, pyesni gjithmonë një specialist të besuar të kujdesit shëndetësor.

Efektet anësore të mundshme:	
<b>Shumë të zakonshme</b> Më shumë se 1 në 10 persona	<ul style="list-style-type: none"><li>● ndjesi e lodhjes</li><li>● ndjesi e përgjithshme e të mos ndierit mirë</li><li>● dhimbje koke</li><li>● marrje mendsh ose të vjella</li><li>● dhimbje muskujsh</li><li>● dhimbje kyçesh</li><li>● ndjeshmëri ose dhimbje krahu në vendin e injeksionit të vaksinës</li></ul>
<b>Të zakonshme</b> Deri në 1 në 10 persona	<ul style="list-style-type: none"><li>● temperaturë (38 gradë Celsius e lart)</li><li>● ethe</li><li>● dhimbje tek ekstremitetet</li><li>● skuqje ose ënjtje e vendit ku është bërë vaksina</li></ul>
<b>Jo të zakonshme</b> Deri në 1 në 100 persona	<ul style="list-style-type: none"><li>● ënjtje e gjëndrave limfatike</li><li>● tension i lartë që zgjat për disa ditë pas vaksinimit</li><li>● acarim i lëkurës</li><li>● skuqje e lëkurës</li><li>● kruarje të përgjithshme</li><li>● kruarje në vendin ku është bërë vaksina</li><li>● alergji</li></ul>
<b>Jashtëzakonisht të rralla</b> Frekuenca nuk dihet ende	<ul style="list-style-type: none"><li>● anafilaksi – një reaksion alergjik i rëndë</li><li>● ndjesi dridhjesh ose shpimi, ose humbje e ndjesisë në disa pjesë të trupit</li><li>● miokardit dhe perikardit. Kjo do të thotë inflamacion i muskulit të zembrës ose i cipës mbështjellëse të muskujve të zembrës. Shihni faqen tjetër për simptomat.</li></ul>

## Simptomat e miokarditit dhe perikarditit

Miokarditi dhe perikarditi janë gjendje inflamatore të zembrës. Edhe pse rreziku i këtyre gjendjeve është shumë i ulët, duhet të keni parasysh shenjat për të pasur kujdes. Këto simptoma mund të zhvillohen brenda pak ditësh pas marrjes së vaksinës dhe kanë ndodhur kryesisht brenda 14 ditëve. Kërkoni ndihmë mjekësore nëse keni një nga këto simptoma pasi të keni bërë këtë vaksinë:

- mosmbushje me frymë
- palpitatione (rrahje të forta të zembrës që mund të jenë të çrregullta)
- dhimbje gjoksi

---

## Ju NUK DUHET ta merrni vaksinën e COVID-19 **Novavax (Nuvaxovid)** nëse

- Keni pasur një reaktion të rëndë alergjik ndaj një prej përbërësve të vaksinës (duke përfshirë polysorbate 80). Lexoni broshurën e informimit të pacientit nga prodhuesi, për të parë listën e përbërësve. Ju lutemi të keni parasysh se vaksinat e COVID-19, Janssen dhe Astrazeneca (Vaxzevria) përmbajnë gjithashtu polysorbate 80.
- Keni pasur një reaktion të rëndë alergjik ndaj një doze të mëparshme të vaksinës.

---

## Flisni me mjekun tuaj përpara se të bëni këtë vaksinë të COVID-19, nëse ju:

- Keni pasur miokardit ose perikardit (inflamacion i muskujve të zembrës ose cipës mbështjellëse të zembrës) pas një doze të mëparshme të vaksinave kundër COVID-19
- Keni pasur një reaktion të rëndë alergjik (anafilaksi) në të shkuarën, duke përfshirë edhe nga vaksina apo medikamente të tjera.

Nëse keni marrë së fundmi vaksinën MPOX (e njohur më parë si lija e majmunëve) (Imvanex ose Jynneos), duhet të prisni 4 javë përpara se të merrni një vaksinë për COVID-19, për shkak të rrezikut të panjohur të miokarditit.

## Çfarë duhet të bëni nëse keni temperaturë ose dhimbje

Nëse keni temperaturë ose nëse keni dhimbje, mund të pini paracetamol ose ibuprofen për lehtësim. Megjithatë, nëse temperatura zgjat më shumë se 48 orë ose nëse jeni ende të shqetësuar, kërkoni këshillë mjekësore.

## Koha e nevojshme për funksionimin e vaksinave

Pas marrjes së vaksinës nevojitet pak kohë, deri në 14 ditë, që sistemi juaj imunitar të përgjigjet dhe t'ju mbrojt nga COVID-19.

Ka prova të forta dhe të besueshme që vaksinat kundër COVID-19 janë shumë efektive në parandalimin e vdekjeve dhe sëmundjes së rëndë me COVID-19 dhe se ato reduktojnë ndjeshëm rrezikun e marrjes së këtij virusi.

Ju duhet të ndiqni gjithashtu këshillat më të fundit të shëndetit publik për të mbrojtur veten dhe të tjerët, në faqen e internetit **[www.hse.ie](http://www.hse.ie)**

## Si të raportoni efektet anësore

Ne jemi duke mësuar ende rreth vaksinave kundër COVID-19. Nëse përjetoni një efekt anësor pas vaksinës suaj kundër COVID-19, ne ju kërkojmë që ta raportoni atë tek Autoriteti Rregullator i Produkteve Shëndetësore (HPRA).

HPRA është autoriteti rregullator në Irlandë për barnat, pajisjet mjekësore dhe produktet e tjera shëndetësore. Vizitoni faqen e internetit **[www.hpra.ie/report](http://www.hpra.ie/report)** për të raportuar një efekt anësor të vaksinës së COVID-19. Mund t'i kërkoni gjithashtu doktorit tuaj ose një pjesëtar të familjes që të raportojë një efekt anësor për ju.



## Informacioni juaj personal

Për të administruar vaksinën në mënyrë të sigurt dhe për të regjistruar gjithë informacionet e nevojshme për monitorimin dhe menaxhimin e vaksinës, HSE do të përpunojë informacionin tuaj personal. Të gjitha informacionet e përpunuara nga HSE do të jenë në përputhje me ligjet e përgjithshme dhe veçanërisht me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR) që ka hyrë në fuqi në vitin 2018.

Përpunimi i të dhënave tuaja do të jetë i ligjshëm dhe i drejtë. Ato do të përpunohen vetëm për qëllimin specifik të menaxhimit të vaksinimeve. Është aplikuar parimi i minimizimit të të dhënave. Kjo do të thotë se regjistrohen vetëm të dhënat e nevojshme për identifikimin tuaj, prenotimin e takimit, regjistrimin e vaksinimit dhe monitorimin e efekteve përkatëse.

Si subjekt të dhënash, keni të drejtat e mëposhtme në kuadër të GDPR për të dhënat tuaja personale që janë përpunuar.

- Të kërkonti informacion për të dhënat tuaja personale dhe të keni qasje në to (që njihet si 'kërkesë për qasje nga subjekti i të dhënave'). Kjo ju mundëson të merrni një kopje të të dhënave personale që mbajmë prej jush dhe të kontrolloni nëse po i përpunojmë në mënyrë të ligjshme.
- Të kërkonti korrigjimin e të dhënave personale që mbajmë prej jush. Kjo ju mundëson korrigjimin e çdo informacioni të paplotë ose të pasaktë që mbajmë prej jush.
- Të kërkonti fshirjen e të dhënave personale. Kjo ju mundëson të kërkonti fshirjen heqjen e të dhënave personale, nëse nuk ka më asnjë arsye që të vazhdojmë t'i përpunojmë. Keni gjithashtu të drejtën të na kërkonti të fshijmë ose të heqim të dhënat personale në rastet kur keni ushtruar të drejtën e kundërshtimit të përpunimit të tyre.
- Kundërshtimi i përpunimit të të dhënave tuaja personale.

Për më shumë informacione, vizitoni [www.hse.ie/eng/gdpr](http://www.hse.ie/eng/gdpr)

## Ku mund të gjeni më shumë informacion

Faqja e internetit [www.hse.ie](http://www.hse.ie) ka informacione të detajuara për COVID-19 nga ekspertët tanë për:

- Vaksinat në dispozicion dhe kush mund t'i marrë ato
- Si të vaksinoheni
- Marrja e vaksinës pas kalimit të sëmundjes
- Dozat e vaksinave të rekomanduara për ju
- Vendimi për vaksinimin e fëmijëve
- Simptomat dhe testimi
- Këshilla për të mbrojtur veten dhe të tjerët

Për më shumë informacion në lidhje me vaksinën që po ju jepet, mund të lexoni broshurën e informimit të pacientit nga prodhuesi. Ajo do të printohet e do t'ju jepet ditën e vaksinës, ose mund ta gjeni në faqen [www.hse.ie/covid19vaccinePIL](http://www.hse.ie/covid19vaccinePIL)

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me vaksinën, mund të flisni me një profesionist shëndetësor, si vaksinuesi, mjeku, farmacisti ose ekipi i kujdesit shëndetësor.

Mund të telefononi gjithashtu HSELive në telefon pa pagesë **1800 700 700**. Ekipi ynë është këtu për të ndihmuar nga e hëna deri të premtën nga ora 08:00 deri në orën 20:00 ose të shtunën dhe të dielën nga 9:00 deri në orën 17:00.





**COVID-19  
VACCINE**  
Public Health  
Advice

Publikuar nga HSE Shtator 2023  
Për informacionet më të përditësuara,  
vizitoni visit [www.hse.ie](http://www.hse.ie)



**Rialtas na hÉireann**  
Government of Ireland